FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 94

Tiranë – E martë, 5 maj 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 29.4.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 297, datë 20.4.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në pronësi, nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare tek Bashkia Sarandë, të pronës me emërtimin "Rezidencë qeveritare", me vendndodhje në zonën kadastrale 8642, Sarandë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare".....	8403
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 305, datë 29.4.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 235, datë 23.3.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të sipërfaqes 9200 m², nga trualli funksional i pronës nr. 206, "Rezidenca qeveritare Sarandë", për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare", të ndryshuar, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 20, datë 9.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Sarandë të qarkut të Vlorës".....	8403
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 29.4.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 319, datë 11.6.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre".....	8404
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 307, datë 29.4.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor '*By-Pass* Fier"', të ndryshuar.....	8406

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 308, datë 29.4.2026	Për kalimin e fondit për t'u përdorur në formën e kapitalit fillestar për shoqërinë "*Albanian Digital Solution*" sh.a.....	8408
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 92, datë 30.4.2026	Për delegimin e kompetencave.....	8408
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 449, datë 27.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	8408
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 459, datë 28.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë.....	8410
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 460, datë 28.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	8411
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 26.3.2026	Xhezair Zaganjori kundër Shqipërisë *(kërkesa nr. 18559/20)*.....	8412
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 9.4.2026	Gerd Gjinarari kundër Shqipërisë *(kërkesa nr. 20617/23)*.....	8417
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 9.4.2026	Edmond Panahori kundër Shqipërisë *(kërkesa nr. 6977/24)*.....	8418
Udhëzim i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nr. 1, datë 30.4.2026	Për përcaktimin e strukturës, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimin e punonjësve të njësisë përgjegjëse në subjektet private.....	8420
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 276/8, datë 30.4.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në njësitë administrative nr. 7 + 9 + 10 – rrugët 'Milo Duçi' dhe 'Prenkë Jakova', Bashkia Tiranë"....	8423
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nr. 62-2026-1590 (163), datë 12.3.2026	Për shpalljen të vdekur të shtetasit Shpëtim Dauti.....	8426

VENDIM
Nr. 304, datë 29.4.2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 297, DATË 20.4.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERITARE TEK BASHKIA SARANDË, TË PRONËS ME EMËRTIMIN "REZIDENCË QEVERITARE", ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8642, SARANDË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 8 e 12, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 297, datë 20.4.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në pronësi, nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare tek Bashkia Sarandë, të pronës me emërtimin "Rezidencë qeveritare", me vendndodhje në zonën kadastrale 8642, Sarandë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, pas fjalëve "... dhe ndërtimin e një Eko-Kampusi" shtohen fjalët "... si dhe për zhvillimin e projektit "Poli i Zhvillimit Turistik Sarandë";";

b) Në pikën 3 hiqen fjalët "... ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.".

2. Ngarkohen Bashkia Sarandë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

VENDIM
Nr. 305, datë 29.4.2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 235, DATË 23.3.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SARANDË TË SIPËRFAQES 9200 M², NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR. 206, "REZIDENCA QEVERITARE SARANDË", PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE", TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 20, DATË 9.1.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SARANDË TË QARKUT TË VLORËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 8 e 12, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 235, datë 23.3.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të sipërfaqes 9200 m², nga trualli

funksional i pronës nr. 206, "Rezidenca qeveritare Sarandë", për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare", të ndryshuar, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 20, datë 9.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Sarandë të Qarkut të Vlorës", bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në pikën 1, pas fjalëve "... për ta përdorur për ndërtimin e një shkolle 9-vjeçare" shtohen "... dhe zhvillimin e programeve parauniversitare.";

b) Në pikën 4, fjalët "... ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim për të tretët ..." hiqen.

2. Ngarkohen Bashkia Sarandë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

VENDIM
Nr. 306, datë 29.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 319, DATË 11.6.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E FORMULARËVE TË KËRKESËS PËR PËRDORIM BURIMI UJOR, DOKUMENTEVE SHOQËRUESE, PROCEDURËS SË SHQYRTIMIT E VENDIMMARRJES, FORMATEVE TË LEJES, AUTORIZIMIT, KUSHTEVE TË POSAÇME DHE AFATEVE TË VLEFSHMËRISË SË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 135, pika 3, 136, pika 7, 137, pika 3, 141, pika 6, e 144, pika 3, të ligjit nr. 29/2024, "Për burimet ujore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shtojcën 1 "Formularët e kërkesës për leje dhe autorizime për përdorim burimi ujor dhe dokumentacioni i kërkuar", të vendimit nr. 319, datë 11.6.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre", bëhen këto ndryshime:

a) Në formularin nr. 23 "Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar", në seksionin III, "Dokumentacioni teknik", tabela pas pikës 13 zëvendësohet me tabelën sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Formulari nr. 38 "Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor për ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale dhe ishujve artificialë në trupa ujorë" zëvendësohet me formularin sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kërkesat e dorëzuara për pajisjen me autorizim për përdorimin e burimeve ujore, sipas formularit nr. 23, të shtojcës 1, të vendimit nr. 319, datë 11.6.2025, të Këshillit të Ministrave, të paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shqyrtohen sipas parashikimeve të formularit nr. 23, që i bashkëlidhet vendimit nr. 319, datë 11.6.2025, të Këshillit të Ministrave, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Kërkesat e dorëzuara për pajisjen me autorizim për përdorimin e burimeve ujore, sipas formularit nr. 38, të shtojcës 1, të vendimit nr. 319, datë 11.6.2025, të Këshillit të Ministrave, të paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shqyrtohen sipas parashikimeve të formularit nr. 38, që i bashkëlidhet vendimit nr. 319, datë 11.6.2025, të Këshillit të Ministrave, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

SHTOJCA 1

Kategoria*	**1**	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**	**12**	**13**
K1 *(≤150 shishe/orë; ≤ 1 l/sek)*	√	√	√	√	√					√	√	√	√
K2 *(>151shishe/orë; >1l/sek)*	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√

SHTOJCA 2

FORMULARI 38

KËRKESË PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIM BURIMI UJOR PËR NDËRTIMIN E STRUKTURAVE ANKORUESE, PORTUALE DHE ISHUJVE ARTIFICIALË NË TRUPA UJORË

I. TË DHËNA MBI VEPRIMTARINË

Emri i burimit ujor _____
Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH)
X _____ Y _____ Z _____
X _____ Y _____ Z _____
X _____ Y _____ Z _____
X _____ Y _____ Z _____
Lloji i burimit ujor ku do të kryhet veprimtaria?
Det ☐

Vijë bregdetare ☐

Të tjera (specifiko) ☐

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet _____

II. DOKUMENTACIONI TEKNIK.

1. Dokumente të pronësisë së tokës (autorizimin/marrëveshjen paraprake për përdorimin e saj nga pronarët/subjektet, nëse veprimtaria shtrihet në prona të pronarëve apo subjekteve të tjera, ose marrëveshjen kontraktuale me autoritetin shtetëror që ka në administrim zonën sipas rastit), me përjashtim të rasteve kur struktura nuk lidhet me tokën;
2. "Leje" nga Administrata Detare në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 (i ndryshuar) (në rastet kur veprimtaria kryhet në det apo vijë bregdetare);
3. Projekti i strukturës që do të ndërtohet;
4. Studimi hidrologjik;
5. Modelimi hidraulik;
6. Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak ose deklarata e ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak, ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";

KËRKUESI: _____
(firma)

VENDIM
Nr. 307, datë 29.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1056, DATË 14.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR *'BY-PASS* FIER"', TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor *'By-pass* Fier"', të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për "tokë bujqësore", me sipërfaqe 837 335.03 (tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e pesë pikë zero tre) m^2, me vlerë 400 103 448.1 (katërqind milionë e njëqind e tre mijë e katërqind e dyzet e tetë pikë një) lekë, për "tokë truall", me sipërfaqe 170 (njëqind e shtatëdhjetë) m^2, me vlerë 406 300 (katërqind e gjashtë mijë e treqind) lekë, si dhe objekte, me vlerë 16 282 001 (gjashtëmbëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e një) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 416 791 749.4 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë pikë katër) lekësh.

...

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 416 791 749.4 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë pikë katër) lekësh përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.".

2. Të dhënat për shpronësim të numrit rendor 26, të tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të emërtuar "Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës "Fier–Vlorë", segmenti Fier – By-pass Levan", zëvendësohen me të dhënat me të njëjtin numër rendor të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në fund të tabelave bashkëlidhur vendimit nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

II. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Albana Koçiu

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 1056, DATË 14.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'BY-PASS–FIER"', TË NDRYSHUAR

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Vlerësimi për shpronësim			Adresat	Shënime
				Të dhënat e pasurisë				Tokë "arë"				
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m^2)	Sipërfaqja e shpronësuar (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera totale (lekë)		
26	Bedrije	Pasho	Mehmetaj	2636	128/25	Ullishte	900	730	437	319,010	Mbrostar-Ura	
	Shaqe	Latif	Agalliu									
	Bektash	Pasho	Veliu									
	Nexhmije	Pasho	Guri									
	Valentina	Pasho	Jermini									
	Shkelqim	Pasho	Veliu									
1	Selim Musa Veliu			2636	73/14	Arë	11564	846	437	369,702	Mbrostar-Ura	
2	Nesti	Zogu	Profka	3436	58/80	Arë	1320	1137	299	339,963	Shtyllas	
3	Nasi	Todi	Zhezha	3980	4/1	Arë	2220	1532	684	1,047,888	Mbrostar-Ferko	
4	Refat	Jonuz	Braka	2436	121/36	Arë	7980	793	335	265,655	Fier	
Shuma totale								**4106.2**		**2,342,218**		
Efekti financiar shtesë 1,935,021.4 lekë												

VENDIM
Nr. 308, datë 29.4.2026

PËR KALIMIN E FONDIT PËR T'U PËRDORUR NË FORMËN E KAPITALIT FILLESTAR PËR SHOQËRINË "*ALBANIAN DIGITAL SOLUTION*" SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar; të ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026"; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 23, pika 1, e 24, pika 1/1, të ligjit nr. 43/2023, "Për qeverisjen elektronike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e fondit, në masën 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë, për t'u përdorur në formën e kapitalit fillestar për shoqërinë "*Albanian Digital Solution*" sh.a., me NIPT: M61615021U.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi përballohet nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për vitin 2026, në zërin "Shpenzime kapitale".

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe shoqëria "*Albanian Digital Solution*" sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

URDHËR
Nr. 92, datë 30.4.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga data 4.5.2026 deri më datë 8.5.2026, zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, z. Xhemal Qefalia.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Punëve të Brendshme, z. Xhemal Qefalia.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

URDHËR
Nr. 449, datë 27.4.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me

temperaturë 55ºC në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57ºC në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65ºC në 39.8 sekonda;

ii. 70ºC në 3.6 sekonda;

iii. 74ºC në 0.5 sekonda;

iv. 80ºC në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3.	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5.	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7.	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chełmża (rural)*
8.	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
9.	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11.	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12.	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13.	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14.	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15.	Mazowieckie	Wołomin	Tłuszcz*
16.	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17.	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18.	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19.	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20.	Pomorskie	Malbork	Miłoradz*
21.	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
22.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
23.	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24.	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25.	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
27.	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29.	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30.	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31.	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
32.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35.	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36.	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37.	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38.	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39.	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40.	Podlaskie	Sokólka	Janów*
41.	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Miedzichowo*
46.	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48.	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Opalenica*
51.	Małopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52.	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53.	Wielkopolskie	Szamotuły	Duszniki*
54.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55.	Mazowieckie	Maków	Płoniawy-Bramura*
56.	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58.	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytoń*
60.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
62.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osięciny*
65.	Dolnośląskie	Milicz	Krośnice*
66.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
67.	Warmińsko-Mazurskie	Iława	Lubawa (rural)*
68.	Łódzkie	Skierniewice	Lipce Reymontowskie*
69.	Łódzkie	Sieradz	Goszczanów*
70.	Wielkopolskie	Śrem	Śrem*
71.	Wielkopolskie	Leszno	Rydzyna*
72.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
73.	Łódzkie	Łowicz	Zduny*
74.	Wielkopolskie	Szamotuły	Kaźmierz*
75.	Wielkopolskie	Pleszew	Gołuchów*
76.	Mazowieckie	Płock (City)	Płock*
77.	Lubuskie	Nowa Sól	Bytom Odrzański*
78.	Zachodniopomorskie	Kamień	Golczewo*
79.	Wielkopolskie	Gostyń	Poniec*
80.	Śląskie	Dąbrowa Górnicza	Dąbrowa Górnicza*
81.	Lubuskie	Nowa Sól	Kożuchów*
82.	Wielkopolskie	Konin	Skulsk*
83.	Lubuskie	Zielona Góra	Nowogród Bobrzański*
84.	Lubuskie	Nowa Sól	Nowa Sól (rural)*
85.	Śląskie	Mikołów	Mikołów*
86.	Mazowieckie	Mława	Szreńsk*
87.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Aleksandrów Kujawski (rural)*
88.	Lubuskie	Sulęcin	Krzeszyce*
89.	**Łódzkie**	**Sieradz**	**Wróblew***
90.	**Opolskie**	**Olesno**	**Zębowice***
91.	**Małopolskie**	**Wieliczka**	**Wieliczka***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk

kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 428, datë 21.4.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Polonisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 459, datë 28.4.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE TË DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e pikës 2.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e lisë së dhenve dhe të dhive të shfaqur në shtetin e Rumanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1.	Mureş	Voivodeni*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe

Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 460, datë 28.4.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55ºC në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55ºC në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55ºC në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57ºC në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65ºC në 39.8 sekonda;

ii. 70ºC në 3.6 sekonda;

iii. 74ºC në 0.5 sekonda;

iv. 80ºC në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1	Bayern	Erding	Steinkirchen*
2	Brandenburg	Oder-Spree	Neuzelle*
3	Bayern	Erding	Bockhorn*
4	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Bestensee*
5	Bayern	Mühldorf am Inn	Neumarkt-Sankt Veit*
6	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Königs Wusterhausen*
7	Bayern	Rottal-Inn	Gangkofen*
8	Brandenburg	Spree-Neiße	Neuhausen/Spree*
9	Brandenburg	Oder-Spree	Spreenhagen*
10	Brandenburg	Oder-Spree	Storkow (Mark)*
11	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Seelow-Land*
12	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Mittenwalde*
13	Bayern	Landshut	Vilsbiburg*
14	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
15	**Brandenburg**	**Märkisch-Oderland**	**Golzow***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Gjermanisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 429, datë 21.4.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 18559/20
XHEZAIR ZAGANJORI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 3 mars 2026, si Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma*, kryetar*,

Diana Kovatcheva,

Canòlic Mingorance Cairat*, gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 18559/20) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa"), më 28 prill 2020 nga shtetasi shqiptar z. Xhezair Zaganjori ("kërkuesi"), i lindur në vitin 1957, me banim në Tiranë dhe i përfaqësuar nga z. A. Toslluku, avokat i licencuar në Tiranë;

tërheqjen e z. Darian Pavli, gjyqtar i zgjedhur për Shqipërinë, për të mos gjykuar çështjen (Rregulli 28 § 3 i Rregullores së Gjykatës);

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë ("Qeveria") të përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm Shtetit, për ankimin në lidhje me të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës private dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me shkarkimin e kërkuesit nga detyra sipas ligjit për vetingun (shihni *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

2. Kërkuesi ka shërbyer si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese që në vitin 2003. Në vitin 2013 ai u emërua në Gjykatën e Lartë dhe shërbeu si kryetar i saj.

3. Më 24 korrik 2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ("KPK") konfirmoi kërkuesin në detyrë sipas të tre komponentëve të procesit të vetingut (vlerësimi i pasurisë, vlerësimi i pastërtisë së figurës dhe vlerësimi profesional). Edhe pse ai identifikoi disa parregullsi dhe mospërputhje në lidhje me vlerësimin e pasurive, vlerësoi që ato nuk e përligjnin shkarkimin e tij nga detyra.

4. Komisioneri publik e ankimoi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit ("KPA"), në lidhje me vlerësimin e pasurisë.

5. KPA-ja zhvilloi disa seanca dhe rishqyrtoi çështjen në bazë të parashtrimeve të Komisionerit publik dhe kërkuesit dhe provave të paraqitura prej tyre. Me vendim të 26 korrikut 2019, KPA-ja përmbysi njëzëri vendimin e KPK-së dhe e shkarkoi kërkuesin nga detyra, sipas nenit 61 (3) të ligjit për vetingun. Ai u shpreh si më poshtë:

6. Më datë 6 korrik 2006, sipas kontratës së shitjes, kërkuesi kishte blerë një apartament në Durrës me çmim 32.000 USD dhe pagesa ishte bërë jashtë zyrës noteriale. Në deklaratën e tij të vitit 2006, ai ka deklaruar tërheqje të shumës prej 1.250.000 lekësh pranë Bankës Italo-Shqiptare në muajin maj 2006. Në deklaratën e vetingut, burimi i

kësaj pasurie është raportuar si të ardhura personale dhe nga qiraja. Gjatë procesit të vetingut, ai ka shpjeguar se shuma 16.000 USD ishte tërhequr nga një depozitë në Bankën Amerikane të Shqipërisë. Ai ka deklaruar se llogaria në atë bankë ishte çelur me shumën 16.000 USD dhe më pas e ka shtuar me 15.000 USD në vitin 2004 dhe 16.000 USD në vitin 2005. Llogaria në bankën Italo-Shqiptare ishte çelur me 1.200.000 lekë. Më tej ai u shpreh që shuma prej 16.000 USD: "*duhet të jetë dhënë në fillim të vitit 2006"*. Megjithatë, kërkuesi kishte bërë një deklarim të pasaktë duke pretenduar që 16.000 USD ishin tërhequr nga llogaria në Bankën Amerikane të Shqipërisë për të financuar blerjen. Të dhënat bankare tregonin që llogaria përkatëse e depozitës e çelur në dhjetor 2004 me 16.093 USD ishte shtuar në 31.576 USD në dhjetor 2005 dhe kishte mbetur e pandryshuar deri në vitin 2008, duke rezultuar pa asnjë tërheqje. Depozita prej 1.200.000 (ekuivalente me përafërsisht 12.000 USD) nga llogaria e çelur në Bankën Italo-Shqiptare në vitin 2004 ishte tërhequr në prill 2006.

7. Kërkuesi kishte mundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet në vitin 2011, me vlerën 455.199 lekë (përafërsisht 3,275 euro (EUR)), por i mungonte aftësia financiare për të bërë të njëjtën gjë në vitin 2012 në shumën 1.402.445 lekë dhe në vitin 2014 në shumën 1.530.109 lekë (përafërsisht 21.000 EUR gjithsej). Për të dalë në këtë konkluzion, KPA-ja zbriti shpenzimet zyrtare të kërkuesit në shumën 5.207 EUR nga llogaritje,t në lidhje me shpenzimet familjare. KPA-ja rrëzoi pretendimin e kërkuesit që kishte deklaruar çdo vit dhe që kishte pasur 900.000 lekë (përafërsisht 6,450 EUR) para fizike në vitet 2012 dhe 2014. Edhe pse ai ka deklaruar 300.000 lekë në vitin 2003 dhe 600.000 në vitin 2004, nuk ka deklaruar asnjëherë ndonjë ndryshim më pas, pavarësisht nga detyrimi ligjor për të deklaruar shtesat ose zbritjet në shumën e parasë fizike çdo vit. Në deklarimet vjetore të mëpasshme, ose në deklaratën e vetingut, nuk u shfaq asnjë gjurmë e asaj shume.

8. Kërkuesi bëri deklarim të pasaktë në lidhje me shpenzimet e tij për shkollimin dhe jetesën e dy familjarëve të tij jashtë vendit.

a) Gjatë procesit të vetingut ai ka deklaruar shuma të ndryshme për periudhën 2008–2014. KPA-ja i pranoi përgjithësisht ato shuma si të konfirmuara nga transaksionet bankare (me sa duket të depozituara në llogaritë e atyre familjarëve), të cilat arrinin në shumën 82.000 GBP për periudhën 2008–2023 – duke përfshirë 17.386 GBP për vitin 2010 dhe 20.565 GBP për vitin 2011 – si edhe 12.024 EUR për vitin 2014. Megjithatë, KPA-ja vlerësoi se kishte mospërputhje të konsiderueshme – 1.700 GBP për vitin 2008, 4.886 GBP për vitin 2010, 7.365 GBP për vitin 2011 dhe 2.977 EUR për vitin 2014 – krahasuar me shumat më të vogla të deklaruara në deklarimet vjetore për të njëjtat shpenzime gjatë këtyre viteve. Vlerësimi i pasurisë në kuadër të procesit të vetingut përfshinte vlerësimin e deklaratave vjetore për të përcaktuar nëse subjekti i vetingut ka bërë deklarim të pasaktë, ka fshehur pasuritë ose ka bërë një deklarim të rremë gjatë viteve të mëparshme. Ndonëse nuk është një faktor i izoluar për të dalë në konkluzion mbi pamjaftueshmërinë e deklarimit dhe shkarkimin nga detyra, vlerësimi i përgjithshëm i deklarimit të vetingut, duke e krahasuar me deklarimet e mëparshme mundësoi vlerësimin e vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të vetingut dhe nxjerrjen e konkluzioneve mbi ligjshmërinë e pasurisë ose mjaftueshmërinë e deklarimeve gjatë viteve, sidomos meqë deklarimet vjetore përmbanin deklarime të kohës për transaksionet. Në fund, u vërejt se diferenca e lartpërmendur për vitin 2014, gjithashtu, e tejkaloi kufirin ligjor për shpenzime që duhej të ishin deklaruar në atë kohë dhe u konsiderua që nuk ishte deklaruar.

b) Kërkuesi nuk kishte paraqitur dokumente për të provuar shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së një familjari të tij jashtë vendit në periudhën 2008-13 (shihni (a) më sipër), ku kërkuesi, gjithashtu, kishte një deficit për vitin 2012 (shihni paragrafin 7 më sipër). KPA-ja refuzoi pretendimin e kërkuesit që kishte qenë e vështirë të siguronte faturat për shkak të kohës së konsiderueshme që kishte kaluar. Ai nuk paraqiti asnjë dokument apo provë për të treguar përpjekjet e bëra për të siguruar këto të dhëna ose për të provuar zhdukjen, humbjen e tyre ose pamundësinë për t'u rikrijuar ose siguruar me mënyra të tjera, duke rezultuar në pamundësinë objektive të paraqitjes së tyre (siç e kërkon nenin 32 (2) i Ligjit për Vetingun).

9. KPA gjithashtu vlerësoi: a) se kërkuesi kishte bërë një deklarim të pasaktë për shkak se shumat e deklaruara prej tij – në deklarimin e vetingut dhe në deklarimin e vitit 2003 – si investimi i tij për ndërtimin e një objekti në periudhën 1997-99 ishin

të ndryshme dhe për shkak se të ardhurat e tij të pretenduara nga dhënia me qira e një pjese të objektit nuk mund të financonin pjesën tjetër, sepse të dyja ishin blerë në të njëjtën kohë sipas kontratës së blerjes në vitin 2001 dhe prandaj deklarimi i tij i vitit 2003 ishte i pasaktë; b) se ai nuk kishte provuar që shuma 6.698.384 lekë për atë investim buronte nga kursimet e tij; c) se ai nuk kishte justifikuar burimet e ligjshme – përfshirë të ardhurat nga qiraja – shpenzimet e kryera gjatë gjysmës së parë të vitit 2006 dhe kishte një diferencë prej 458.761 lekë (përafërsisht 3700 EUR), sidomos për financimin e apartamentit të lart përmendur në Durrës; ai vetëm ishte bërë bashkëpronar i disa ambienteve në objektin e lart përmendur sipas kontratës së blerjes në vitin 2001, nuk kishte qenë pjesë e ndonjë kontrate qiraje për ato hapësira deri në shkurt 2003 dhe nuk kishte paraqitur provë të mjaftueshme për pagesën e tatimit për të ardhurat nga qiraja deri në vitin 2007; dhe d) që dokumentet e paraqitura nga kërkuesi nuk provonin plotësisht që akomodimi dhe shpenzimet e shkollimit të anëtarit të dytë të familjes së tij jashtë vendit justifikonin shpenzimet e deklaruara nga kërkuesi për vitin 2014-17.

10. Rezulton kërkuesi ka marrë tekstin e plotë të vendimit të KPA-së me *email* më 25 tetor 2019 dhe me postë në një datë të paspecifikuar.

11. Kërkuesi u ankua sipas nenit 8 të Konventës që shkarkimi i tij nga detyra kishte qenë arbitrar dhe shproporcional, sepse bazohej në parregullsi ose mospërputhje të vogla.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Objekti i çështjes

12. Në parashtrimet e tij në vitin 2024, kërkuesi përfshiu disa pretendime të reja për herë të parë, sidomos që trupi gjykues i KPA-së nuk ishte "krijuar me ligj", për shkak të moskualifikimit të pretenduar të L.D. për t'u emëruar si gjyqtar i KPA-së. Këto pretendime nuk janë shtjellim i ankimit fillestar të komunikuar që kishte të bënte me shkaqet për shkarkimin e kërkuesit nga detyra. Prandaj ajo janë jashtë objektit të çështjes në fjalë (shihni *Kulák kundër Sllovakisë*, nr. 57748/21, § 52, 3 prill 2025).

B. Neni 8 i Konventës

1. Parashtrimet e palëve

a) Qeveria

13. Qeveria rikonfirmoi gjetjet dhe konkluzionet e KPA-së. Shkaqe për shkarkimin e kërkuesit – bazuar në problemet me të ardhurat nga qiraja, mungesën e burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet për vitin 2012 dhe 2014 dhe blerjen e një apartamenti – kishin të bënin me periudhën kur ai kishte shërbyer si gjyqtar dhe për të cilën ai kishte paraqitur deklarimet që në vitin 2003. Kërkuesi nuk ka specifikuar ndonjë standard alternativ për llogaritjen e shpenzimeve për periudhën 2012-14 që do të ishte më i saktë ose i përshtatshëm për situatën e tij dhe nuk ka dhënë llogaritje të sakta të tepricave të pretenduara si të gjeneruara gjatë asaj kohe për të treguar se vlerësimi i bërë nga KPA-ja, në lidhje me shpenzimet e tij kishte qenë i pasaktë ose i paarsyeshëm. KPA-ja kishte identifikuar mospërputhje, në lidhje me një lloj specifik të shpenzimeve në disa deklarime ndërmjet 2008 dhe 2014.

b) Kërkuesi

14. Kërkuesi pretendoi se ishte shkarkuar nga detyra për mospërputhje ose parregullsi të vogla të bëra përpara vitit 2003, kur ishte bërë gjyqtar, dhe jo për ndonjë shkelje të rëndë, siç është deklarimi i rremë ose fshehja e pasurisë. Nuk kishte të dhëna për stil jetese të ekzagjeruar dhe nuk kishte vepruar asnjëherë në keqbesim kur kishte paraqitur deklarimet e pasurisë.

15. Kontrata e blerjes e vitit 2006 dhe fondet për të ishin deklaruar rregullisht në deklarimin vjetor. 40% e shumës ishte tërhequr nga banka dhe i ishte paguar shitësit. KPA-ja kishte vërejtur që kërkuesi nuk mund të ofronte prova të tjera, për shkak se kishte kaluar një kohë e konsiderueshme. Të ardhurat e familjes së tij në vitin 2005 dhe 2006 të marra veçmas e mbulonin plotësisht shumën e paguar për apartamentin. KPA-ja nuk e kishte marrë këtë gjë parasysh në mënyrë të paarsyeshme dhe kishte keqinterpretuar faktet dhe provat e paraqitura, duke mos arritur që të japë arsye për interpretimin e ndryshëm.

16. Metodologjia e përdorur për të llogaritur shpenzimet vjetore për vitin 2012 dhe 2014 kishte qenë e pasaktë. Të ardhurat dhe kursimet e mëparshme të familjes së tij duhej të ishin vlerësuar. Në deklarimet e tij vjetore ai kishte treguar një tepricë prej 3.200.000 lekësh në vitin 2011 dhe 3.900.000 lekësh në vitin 2013 dhe shumë në para fizike për shpenzime në raste emergjence. Gjithashtu, shpenzimet e lidhura me punën që i kishte paguar me kartën e tij të kreditit i ishin rimbursuar.

17. Kërkuesi pretendoi se nuk ishte pyetur asnjëherë më parë për deklarimet e tij vjetore. Kur u

pyet gjatë procesit të vetingut, ai sqaroi me detaje të gjitha pagesat dhe paraqiti të gjitha dokumentet e transfertave bankare që në vitin 2008. Kishte disa mospërputhje në lidhje me shpenzimet për studimet e një familjari jashtë vendit, për shkak të "mungesës së metodologjisë" në deklarimin vjetor të kërkuesit për periudhën 2009-11. Megjithatë, ai e sqaroi situatën në deklarimin e vetingut dhe paraqiti të gjitha provat në dispozicion. Duke pasur parasysh kohën e konsiderueshme që kishte kaluar, ai, apo familjarët e tij, nuk i kishin mbajtur të gjitha faturat në lidhje me shpenzimet e kryera, sepse nuk kishin dijeni që ato do të kërkoheshin në vitin 2017 për procesin e vetingut. Objektivisht kishte qenë e pamundur që të siguroheshin të gjitha këto dokumente dhe disa pasaktësi ishin të pashmangshme. Sidoqoftë, asnjë gjë nuk ishte fshehur dhe të gjitha shpenzimet ishin mbuluar plotësisht me të ardhurat e siguruara nga kërkuesi dhe bashkëshortja e tij gjatë atyre viteve.

2. Vlerësimi i Gjykatës

18. Shkarkimi i kërkuesit nga detyra përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës private (shihni *Thanza kundër Shqipërisë,* nr. 41047/19, §§ 135 dhe 137, 4 korrik 2023). Kërkuesi e pranoi që ndërhyrja kishte qenë në përputhje me ligjin dhe qëllimet legjitime të ndjekura (shihni edhe *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, §§ 75 dhe 79, 13 dhjetor 2022), por pretendoi që kishte qenë shproporcionale.

19. Komisioneri Publik ankimoi konkluzionet e KPK-së vetëm në lidhje me elementin e parë të procesit të vetingut (shihni paragrafët 4 dhe 5 më sipër). KPA-ja e bazoi shkarkimin e kërkuesit nga detyra në nenin 61 (3) të ligjit për vetingun dhe gjeti një deficit në vitin 2012 dhe 2014. Gjithashtu, vërejti që ai kishte bërë deklarime të paplota, të pasakta në lidhje me: i. shumat për sponsorizimin e shpenzimeve të familjarëve të tij jashtë vendit gjatë disa viteve; dhe ii. burimin për financimin e blerjes së një apartamenti në vitin 2006. Gjykata do të trajtojë më poshtë ankimet për këto gjetje, që gjithashtu kishin të bënin me kohën kur kërkuesi kishte qenë gjyqtar i lartë dhe subjekt i kërkesave të ligjit të vitit 2003 për deklarimin e pasurisë.

20. Në lidhje me gjetjet e KPA-së, të përmendura më sipër, bazuar në nenin 6 të Konventës, kërkuesi pretendoi që kishte mangësi procedurale në vendimin që rezultoi në shkarkimin e tij nga detyra. Këto ankime ishin shpallur të papranueshme në kohën e komunikimit të kësaj kërkese. Në parashtrimet e tij në vitin 2024, kërkuesi rikonfirmoi disa nga ato ankime, sipas nenit 8. Gjykata nuk ka identifikuar mangësi të rënda në procesin e vendimmarrjes me anë të të cilit në nivel kombëtar u nxorën konstatimet e mësipërme dhe nuk sheh arsye për të dalë në një konkluzion të ndryshëm për pranueshmërinë e atyre pretendimeve, sipas nenit 8 (krahasoni *Thanza*, cituar më sipër, § 158).

21. Së dyti, në lidhje me proporcionalitetin, kërkuesi në thelb pretendoi se gjetjet e KPA-së për pikat e shprehura në paragrafin 19 më sipër ishin arbitrare dhe të paarsyeshme. Siç janë paraqitur, këto pretendime mbeten të paprovuara dhe konkluzionet e KPA-së nuk duket se arrijnë kufirin e arbitraritetit apo mungesës së dukshme të arsyes (shihni *Yüksel Yalçınkaya kundër Turqisë* [DHM], nor. 15669/20, § 304 *in fine*, 26 shtator 2023, dhe *Xhoxhaj,* cituar më lart, § 407). Në veçanti, Gjykata vëren se KPA ka dhënë arsye për rrëzimin e pretendimeve të kërkuesit në lidhje me aftësinë e tij financiare për vitet 2012 dhe 2014. Njëkohësisht, ai nuk ka paraqitur ndonjë element apo provë bindëse që do të tregonte ndonjë gabim ligjor apo faktik të dukshëm në arsyetimin, llogaritjet ose metodën e KPA-së (shihni *Jaupi kundër Shqipërisë*, nr. 23369/16, § 119, 29 prill 2025, dhe krahasoni *Sevdari*, cituar më sipër, § 96).

22. Prandaj, Gjykata do të vlerësojë pretendimin fillestar për shproporcionalitetin në bazë të fakteve siç u përcaktuan dhe vlerësuan nga KPA-ja.

23. Kërkuesi u shpreh se një pjesë e konsiderueshme e fondeve të përdorura për të blerë apartamentin në vitin 2006 (16.000 USD, e pretenduar e mbledhur nga kursimet që rrjedhin nga të ardhurat e punësimit dhe qirasë) ishte tërhequr nga një llogari në Bankën Amerikane të Shqipërisë. KPA-ja vendosi që nuk ishte bërë tërheqje nga ajo llogari gjatë periudhës përkatëse. Shuma e tërhequr nga një llogari në një bankë tjetër nuk dukej e mjaftueshme për të shpjeguar deklarimin e pasaktë. Një deklarim i saktë dhe i provuar për burimin thelbësor të një pasurie të konsiderueshme dhe lëvizja e fondeve të mëdha, në lidhje me atë – pagesë me para fizike pas një tërheqjeje bankare ose përmes transfertës bankare – ishte thelbësore për të siguruar gjurmueshmërinë dhe për të verifikuar ligjshmërinë e origjinës së fondeve dhe aspekte të tjera të ligjshmërisë dhe mjaftueshmërisë së këtyre fondeve.

Kërkuesi nuk arriti të jepte shpjegim të besueshëm (shihni paragrafët 6 dhe 15 më sipër).

24. Shumat e deklaruara rishtazi dhe të pranuara gjatë procesit të vetingut, për viten 2010, 2011 dhe 2014, ishin mjaft më të larta se ato të raportuara për të njëjtin lloj shpenzimi të përsëritur në deklarimet vjetore përkatëse. Këto diferenca kishin të bënin me disa vite dhe nuk ishin të vogla, si në terma absolutë, ashtu edhe në raport me madhësinë e shpenzimeve. Për shembull, shuma e diferencës për vitin 2014 e tejkalonte kufirin ligjor për shpenzimet që duheshin deklaruar (shihni paragrafin 8 (a) më sipër dhe *Thanza*, përmendur më sipër § 68). Gjithashtu, Gjykata vëren se në vitin 2014 kishte një deficit vjetor të përgjithshëm (shihni paragrafin 7 më sipër). Ndonëse u paraqit dokumentacion, në lidhje me veprimtarinë e llogarisë bankare, të marra së bashku me veprime të ngjashme për vitet e tjera, ky kontekst kërkonte vlerësim të kujdesshëm të saktësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve. Këto mospërputhje nuk ishin shpjeguar si duhej.

25. Gjithashtu, kërkuesi nuk arriti të provojë shpenzimet e shkollimit dhe jetesës për një anëtar të familjes, që i korrespondojnë shumave të cilat rezultojnë nga veprimtaria bankare në periudhën 2008-13 (shihni paragrafin 8 (b) më sipër). Mes palëve nuk ka pasur mosmarrëveshje që kërkesa për të vërtetuar shumën aktuale, të paktën, të kategorive kryesore të atij shpenzimi madhor (mbi 82,000 GBP, shihni paragrafin 8 (a) më sipër) – për shembull, akomodim ose shkollim – ishte në përputhje me qëllimet legjitime të procesit të vetingut. Gjithashtu, duket se sipas ligjit për deklarimin e pasurisë 2003, mund të pritej që kërkuesi të mbante dokumentet përkatëse (shihni *Xhoxhaj*, cituar më lart, §§ 201-03). Sidoqoftë, ai nuk tregoi se kishte marrë masa për të siguruar ato dokumente gjatë procesit të vetingut, ndërsa e kishte bërë këtë gjë për vitet vijuese (shihni paragrafin 9 (d) më sipër).

26. Deficitet e përgjithshme vjetore të identifikuara për 2012 dhe 2014 ishin objektivisht të konsiderueshme (shihni paragrafin 7 më sipër). Pretendimi i kërkuesit që të ardhurat në dispozicion të familjes së tij brenda periudhës 2011 deri në 2014 tejkalonin në masë të konsiderueshme shpenzimet e përgjithshme për atë periudhë nuk është provuar dhe nuk rrëzon konkluzionet e KPA-së në lidhje me dy vite specifike. Kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë argument apo provë bindëse për të kundërshtuar, shpjeguar ose justifikuar këto deficite (shihni paragrafët 16 dhe 21 më sipër).

27. Nëse gjykatat e brendshme kanë shqyrtuar me kujdes faktet, kanë zbatuar standardet e të drejtave të njeriut në përputhje me Konventën dhe praktikën gjyqësore, dhe kanë balancuar si duhet interesin personal me interesin publik në një çështje, Gjykata do të kërkonte arsye të forta për të zëvendësuar këndvështrimin e saj me atë të gjykatave të brendshme (shihni *Halet kundër Luksemburgut* [DHM], nr. 21884/18, § 161, 14 shkurt 2023). Duke i marrë së bashku faktorët e lartpërmendur dhe duke vërejtur pozicionin e kërkuesit si gjyqtar i lartë, i cili ka mbajtur pozicionin më të lartë në sistemin gjyqësor gjatë procesit të vetingut (shihni *Xhoxhaj*, përmendur më lart, § 407 *in fine*) arsyet e dhëna prej tij janë të pamjaftueshme që Gjykata të devijojë nga konkluzionet e KPA-së dhe, në terma të përgjithshëm, të ndikojë në rezultatin e çështjes së vetingut. Prandaj, Gjykata nuk gjen që shkarkimi i tij nga detyra ka qenë shproporcional.

28. Nisur nga ky konkluzion, nuk është e nevojshme që Gjykata të bëjë një shqyrtim të detajuar të gjetjeve dhe konkluzioneve të tjera të KPA-së (krahasoni *Thanza*, cituar më sipër, § 160).

29. Në këto rrethana, ankimi sipas nenit 8 është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 26 mars 2026.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELARE

Peeter Roosma
KRYETAR

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 20617/23

GERD GJINARARI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 17 mars 2026 si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetare,*
Darian Pavli,
Mateja Đurović, *gjyqtarë*
dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Në lidhje me:

kërkesën (nr. 20617/23) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") më 16 maj 2023 nga një shtetas shqiptar, z. Gerd Gjinarari ("kërkuesi"), i cili ka lindur në vitin 1974, banon në Tiranë dhe u përfaqësua nga z. A. Saccucci, dhe znj. G. Borgna, avokatë, të cilët e ushtrojnë profesionin në Romë;

vendimin për të njoftuar mbi kërkesën qeverinë shqiptare ("Qeveria"), përfaqësuar nga Agjenti i saj, z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

konstatimet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me procedurat për kërkesën e kërkuesit për lirimin e tij të parakohshëm nga burgu.

2. Në vitin 1997 dhe 2002, gjykatat italiane e shpallën kërkuesin fajtor për falsifikim të dokumenteve, vrasje në rrethana rënduese, mbajtje të armëve të zjarrit, prodhimin dhe tregtimin e narkotikëve dhe kryerjen e krimeve nga një grup i armatosur, dhe e dënoi atë me burgim të përjetshëm.

3. Më 10 mars 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë njohu vendimet e gjykatave italiane. Më 24 nëntor 2014, kërkuesi u transferua në Shqipëri për të vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm.

4. Më 14 shkurt 2019, Gjykata e Rrethit Korçë e pranoi kërkesën e kërkuesit për lirim të parakohshëm, dhe kërkuesi u lirua. Megjithatë, mbështetur në apelimin e prokurorisë, më 26 qershor 2019, Gjykata e Apelit Korçë e prishi vendimin duke e rrëzuar kërkesën e kërkuesit.

5. Më 6 gusht 2019, kërkuesi paraqiti një apelim pranë Gjykatës së Lartë që u rrëzua më 14 qershor 2022.

6. Më 14 nëntor 2022, kërkuesi paraqiti një apelim kushtetues që u shpall i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese më 16 janar 2023, pasi ishte dorëzuar jashtë afatit 4-mujor, duke e nisur numërimin që prej datës së vendimit të Gjykatës së Lartë.

7. Pas lirimit të tij nga burgu në vitin 2019, kërkuesi është i arratisur,dhe vendndodhja e tij mbetet e paditur.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Neni 6 § 1 i Konventës

8. Kërkuesi u ankua për shkelje të së drejtës së tij për t'iu drejtuar një gjykate, për shkak të përllogaritjes nga Gjykata Kushtetuese të afatit kohor për paraqitjen e një ankesë kushtetuese.

9. Gjykata përsërit se shqyrtimi i kërkesave për lirim të parakohshëm nga paraburgimi, ose i çështjeve në lidhje me mënyrën e ekzekutimit të një dënimi me burgim, nuk i përket fushës së veprimit të nenit 6 § 1 të Konventës. Një shqyrtim i tillë nuk ka të bëjë as me përcaktimin e një "akuze penale" dhe as me përcaktimin e "të drejtave dhe detyrimeve civile", sipas interpretimit të këtij neni (shih, midis të tjerësh, *Enea kundër Italisë [DHM]* nr. 74912/01, § 97, GJEDNJ 2009; *Boulois kundër Luksenburgut [DHM]* nr. 37575/04, § 87, GJEDNJ 2021; dhe *Dybeku kundër Shqipërisë* nr. 41153/06, § 55, 18 dhjetor 2007, të gjitha me referenca të tjera).

10. Rrjedhimisht, kjo ankesë është e papajtueshme *ratione materiae* me parashikimet e Konventës, sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a), dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 § 4.

B. Ankesa të tjera

11. Këto ankesa nuk iu komunikuan Qeverisë së paditur, por ato janë të papranueshme për arsyet e paraqitura në vijim.

12. Në mbështetje të neneve 3 dhe 7 të Konventës, kërkuesi u ankua se parashikimeve të Kodit Penal të Shqipërisë që rregullonin lirimin e parakohshëm iu mungonte qartësia dhe parashikueshmëria, se të burgosurit me burgim të përjetshëm bëheshin të ligjshëm për lirim të parakohshëm, vetëm pasi të kishin vuajtur tridhjetë e pesë vjet, se ligji parashikonte mundësinë e lirimit të parakohshëm, pasi të ishte arritur rehabilitimi, por

pa rregulluar programe individuale të rehabilitimit dhe, se në rastin e kërkuesit, kishte pasur një zbatim prapaveprues të dispozitave të Kodit Penal, që kishin të bënin me lirimin e parakohshëm.

13. Gjykata thekson se kërkuesi ishte liruar në vitin 2019, pasi gjykata e shkallës së parë kishte pranuar kërkesën e tij për lirim të parakohshëm. Që prej atij momenti, vendndodhja e tij mbetet e panjohur, edhe pse në formularin e kërkesës së tij ai kishte listuar një adresë në Tiranë si vendbanimin e tij. Në këtë mënyrë, pasi gjykata e apelit rrëzoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi nuk u kthye të vuante pjesën e mbetur të dënimit të tij.

14. Gjykata vlerëson se garancitë, sipas neneve 3 dhe 7 të Konventës për mundësinë e lirimit të të burgosurve me burgim të përjetshëm, zbatohet vetëm për personat që tashmë janë në burgim dhe po shërbejnë dënimin e tyre. Qëllimi i këtyre garancive është që të burgosurve që vuajnë dënimin me burgim të përjetshëm t'u jepet mundësia të bëjnë kërkesë për lirim (krahaso me parimet e paraqitura në *Murray kundër Holandës [DHM]* nr. 10511/10, §§ 99-104, 26 prill 2016). Këto garanci humbasin kuptimin për personat që janë në gjendje të lirë. Gjykata vëren se, në çështjen konkrete, pavarësisht ekzistencës së vendimeve gjyqësore të vlefshme që e dënojnë kërkuesin me burgim të përjetshëm dhe që më pas rrëzojnë lirimin e tij të parakohshëm, ai nuk është i ndaluar fizikisht dhe është i arratisur nga drejtësia.

15. Rrjedhimisht, këto ankesa janë qartazi të pambështetura dhe duhet të rrëzohen në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 9 prill 2026.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Úna Ní Raifeartaigh
KRYETARE

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 6977/24

EDMOND PANAHORI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 17 mars 2026, si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetare,*
Darian Pavli,
Mateja Đurović, *gjyqtarë*
dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Në lidhje me:

kërkesën (nr. 6977/24) kundër Republikës së Shqipërisë, të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") më 1 mars 2024 nga një shtetas shqiptar, z. Edmond Panahori ("kërkuesi"), i cili ka lindur në vitin 1974, është i burgosur në Fier dhe u përfaqësua nga z. A. Syri, një avokat i cili e ushtron profesionin në Berat;

vendimin për të njoftuar mbi kërkesën qeverinë shqiptare ("Qeveria"), përfaqësuar nga Agjenti i saj, z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

konstatimet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me procedurat penale ndaj kërkuesit. Kërkuesi u ankua për mungesë të aksesit në Gjykatën Kushtetuese dhe pamundësinë e tij për të marrë pjesë në procedurat pranë Gjykatës së Lartë.

2. Më 19 nëntor 2013, pas procedurave të përshpejtuara, Gjykata e Rrethit Fier e dënoi kërkuesin me dhjetë vjet burgim për vrasje. Në apel, ai vendim u reduktua në gjashtë vjet dhe gjashtë muaj nga Gjykata e Apelit Vlorë. Më 12 mars 2015, Prokuroria e Vlorës paraqiti një apelim pranë Gjykatës së Lartë me argumentin se dënimi i dhënë ishte shumë i butë.

3. Më 27 mars 2015, kërkuesi, i cili ishte në burgim në atë kohë, u njoh me apelimin e prokurorisë.

4. Më 19 maj 2015, Gjykata e Lartë e shpalli apelimin e prokurorisë të pranueshëm.

5. Në vitin 2017, kërkuesi e përfundoi vuajtjen e dënimit të tij në Shqipëri dhe më 13 maj 2017 u zhvendos në Itali.

6. Gjykata e Lartë e dërgoi njoftimin e datës se kur do të vlerësohej çështja e kërkuesit në burgun ku ai kishte vuajtur dënimin. Autoritetet e burgut e informuan Gjykatën e Lartë se kërkuesi e kishte përfunduar dënimin e tij dhe nuk ishte më në atë burg. Më pas, Gjykata e Lartë e dërgoi njoftimin në adresën e shtëpisë së kërkuesit në fshatin Mbres. Megjithatë, njoftimi nuk iu dha kërkuesit, sepse ai nuk jetonte më atje.

7. Gjykata e Lartë caktoi një avokat që ta përfaqësonte kërkuesin dhe gjykoi çështjen në mungesë të kërkuesit. Më 26 korrik 2021, Gjykata e Lartë e prishi vendimin e apelit dhe la në fuqi vendimin e shkallës së parë. Ky vendim u publikua në faqen e saj të internetit më 9 nëntor 2021.

8. Me kthimin e tij në Shqipëri më 7 maj 2023, kërkuesi u arrestua menjëherë dhe u njoh me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 26 korrik 2021.

9. Më 31 gusht 2023, kërkuesi paraqiti një ankesë kushtetuese me argumentin se ai kishte mësuar për vendimin e kontestuar të Gjykatës së Lartë më 7 maj 2023.

10. Më 25 tetor 2023, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankesën kushtetuese të kërkuesit të papranueshme, pasi ishte paraqitur jashtë afatit katërmujor, duke nisur llogaritjen që prej datës 9 nëntor 2021. Gjykata Kushtetuese gjykoi se më 27 mars 2015, kërkuesi ishte njohur me ankesën e prokurorisë bërë në Gjykatën e Lartë dhe, për këtë arsye, kërkuesi kishte detyrimin të ndiqte ecurinë e çështjes së tij pranë Gjykatës së Lartë dhe të kërkonte informacion për të. Gjykata Kushtetuese nuk e pranoi pretendimin e kërkuesit se ai kishte mësuar për vendimin e Gjykatës së Lartë më 7 maj 2023, si provë të mjaftueshme se me të vërtetë ai ishte vënë në dijeni për gjykimin e kontestuar në atë datë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

Neni 6 § 1 i Konventës

1. Aksesi në Gjykatën Kushtetuese

11. Kërkuesi u ankua për shkelje të së drejtës së tij për t'iu drejtuar një gjykate, duke iu referuar përllogaritjes së Gjykatës Kushtetuese të afatit kohor për paraqitjen e një ankese kushtetuese.

12. Gjykata ka shqyrtuar çështjen e aksesit në Gjykatën Kushtetuese, për shkak të përllogaritjes së afatit katërmujor në *Supergrav Albania sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 20702/18, 9 maj 2023.

13. Duke u kthyer në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi u vu në dijeni të apelimit të prokurorisë në Gjykatën e Lartë më 27 mars 2015 (shih paragrafin 3 më sipër), dhe për këtë arsye kishte dijeni se proceset e Gjykatës së Lartë ishin pezull pranë kësaj gjykate. Megjithatë, kur kërkuesi u lirua nga burgu në vitin 2017, ai nuk pyeti për çështjen e tij pranë Gjykatës së Lartë dhe as nuk i dha Gjykatës së Lartë adresën e tij të re. Për këtë arsye, Gjykata e Lartë dërgoi fletëthirrje fillimisht në burg, dhe më pas në fshatin Mbres, në të vetmen adresë që kishte për kërkuesin në dosje.

14. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se, arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese që e shpall të papranueshme ankesën kushtetuese të kërkuesit dhe përllogarit afatin nga data e vendimit të Gjykatës së lartë, nuk mund të shihet si arbitrar. Gjykata Kushtetuese vlerëson me të drejtë se duke qenë se kërkuesi kishte qenë në dijeni të procedurave pezull pranë Gjykatës së Lartë, ishte detyra e tij që të ndiqte ecurinë e këtyre procedurave, ose të paktën të paraqiste adresën e tij të përditësuar pranë Gjykatës së Lartë për njoftime të mëtejshme.

15. Mbështetur në sa më sipër, kërkuesi nuk veproi me kujdesin e duhur të kërkuar për t'i bërë të mundur Gjykatës së Lartë që t'i dërgonte atij fletëthirrjet dhe vendimin e formës së prerë. Për këtë arsye, interpretimi i Gjykatës Kushtetuese për rregullat procedurale të zbatueshme në çështjen konkrete përbente një kufizim proporcional të së drejtës së kërkuesit për t'iu drejtuar një gjykate, gjë që nuk cenonte thelbin e asaj të drejte (shih *Johansen kundër Gjermanisë* nr. 17914/10, §§ 46-57, 15 shtator 2016).

16. Për rrjedhojë, kjo ankesë është qartazi e pambështetur dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

2. E drejta e kërkuesit për të marrë pjesë në procedurat pranë Gjykatës së Lartë

17. Kërkuesi u ankua edhe se ishte shkelur e drejta e tij për të marrë pjesë në procedurat pranë Gjykatës së Lartë dhe e drejta e tij për t'u njoftuar për vendimin e tij.

18. Gjykata ka pranuar arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese, duke e shpallur të papranueshme ankesën kushtetuese të kërkuesit. Rrjedhimisht, të gjitha ankesat e tjera që kërkuesi ka ngritur janë të papranueshme për mosshterim të mjeteve vendëse,

pasi kërkuesi nuk respektoi rregullat proceduralë për paraqitjen e një ankese kushtetuese.

19. Në këtë mënyrë, kjo pjesë e kërkesës duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshterim të mjeteve vendëse.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 9 prill 2026.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Úna Ní Raifeartaigh
KRYETARE

UDHËZIM
Nr. 1, datë 30.4.2026

PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS, KRITERET E PËRZGJEDHJES DHE TRAJNIMIN E PUNONJËSVE TË NJËSISË PËRGJEGJËSE NË SUBJEKTET PRIVATE

Në mbështetje të pikës 13, të nenit 14, të ligjit nr. 96, datë 18.12.2025, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI),

UDHËZON:

Përcaktimin e rregullave për miratimin e strukturës, kritereve të përzgjedhjes dhe të trajnimit të punonjësve të njësisë përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet, në subjektet private, si më poshtë vijon:

1. Subjektet private, sipas përkufizimit të ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, të cilët kanë më shumë se 50 punonjës, si dhe çdo ent me kapital shtetëror apo që është nën kontrollin e subjekteve shtetërore, ngarkohen për të krijuar njësi përgjegjëse për sinjalizimin, për të garantuar funksionimin efektiv të një mekanizmi të brendshëm të dedikuar për raportimin dhe hetimin administrativ të sinjalizimeve të brendshme dhe kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.

2. Subjektet private duhet të caktojnë njësinë përgjegjëse, si organ i posaçëm, i përbërë nga një ose më shumë persona, në varësi të numrit të punonjësve të subjektit, të trajnuar posaçërisht në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve, e cila regjistron, heton dhe shqyrton administrativisht sinjalizimet, si dhe shqyrton kërkesat për mbrojtjen e sinjalizuesit nga hakmarrja sipas përcaktimeve të ligjit dhe këtij udhëzimi.

3. Subjektet private pavarësisht nga numri i punonjësve, të cilët ushtrojnë veprimtari në fushat e shërbimeve financiare, të produkteve dhe të tregjeve financiare, të sigurimeve të fondeve të pensionit, të parandalimit të pastrimit të parave e të financimit të terrorizmit, si dhe në çdo fushë tjetër të parashikuar nga aktet e Bashkimit Evropian, ngarkohen për të ngritur njësi përgjegjëse si mekanizëm i brendshëm raportimi për sinjalizimin.

4. Subjektet private dhe njësitë përgjegjëse të krijuara në zbatim të nenit 14, pika 10, të ligjit nr. 96/2025, e rregullojnë marrëdhënien juridike midis tyre nëpërmjet një marrëveshjeje të posaçme me shkrim, në përputhje me kuadrin ligjor në fushën e së drejtës civile. Subjektet private sigurohen që njësia e përbashkët përgjegjëse të garantojë, në çdo rast, respektimin e parimit të konfidencialitetit, të së drejtës për informim dhe detyrimit për të trajtuar çdo rast të sinjalizuar dhe kërkesë për mbrojtje.

5. Subjektet private të cilat kanë 250 ose më shumë punonjës nuk mund të krijojnë një njësi përgjegjëse të përbashkët për trajtimin e sinjalizimit apo kërkesës për mbrojtje.

6. Subjektet private, me qëllim përzgjedhjen e përbërjes së njësisë përgjegjëse, mund të konsultohen me organizatat sindikale ose të punëdhënësve, të lidhura me subjektin, të cilat janë të njohura në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës. Subjektet private vlerësojnë mendimin e këtyre të fundit në raport me kapacitetet e tyre të burimeve njerëzore.

7. Subjektet private, të cilat përcaktojnë një palë të tretë të jashtme si njësi përgjegjëse, marrëdhënien juridike midis palëve e rregullojnë me një marrëveshje të posaçme me shkrim, në përputhje me kuadrin ligjor në fushën e së drejtës civile.

8. Subjektet private sigurohen që palët e treta, në ushtrimin e funksioneve të tyre si njësi përgjegjëse, të ofrojnë garancitë e duhura për respektimin e pavarësisë, konfidencialitetit, mbrojtjes së të dhënave dhe anonimitetit të sinjalizuesit e personave të përfshirë në procesin e sinjalizimit ose të kërkesës për mbrojtje.

9. Subjektet private, të cilat kanë caktuar një palë të tretë si njësi përgjegjëse, nuk përjashtohen nga përgjegjësia për garantimin e funksionimit efektiv të mekanizmit të brendshëm të sinjalizimit, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të këtij udhëzimi.

10. Subjektet private, të cilat janë të organizuara dhe ushtrojnë veprimtarinë në formën e shoqërive të kontrolluara nga shoqëria mëmë, sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, kjo e fundit mund të hartojë rregulloren për hetimin e sinjalizimit dhe kërkesës për mbrojtje, të zbatueshme edhe për shoqëritë e kontrolluara. Ky parashikim nuk përjashton shoqëritë e kontrolluara nga detyrimi për krijimin e njësisë së tyre përgjegjëse, në kuptim të ligjit dhe të këtij udhëzimi.

11. Njësia përgjegjëse apo pala e tretë e jashtme e ngarkuar me këtë funksion, ka për detyrë:

a) të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenin 15 e vijues të ligjit;

b) të veprojë me ndershmëri, integritet, paanshmëri, efikasitet dhe jashtë çdo ndikimi të padrejtë që mund të pengojë përmbushjen e detyrave të saj në zbatim të ligjit;

c) të pranojë, të regjistrojë dhe të konfirmojë marrjen e sinjalizimit, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes, përveç rasteve kur sinjalizuesi ka kërkuar shprehimisht të mos marrë konfirmim ose kur konfirmimi rrezikon mbrojtjen e identitetit të tij;

ç) të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes, ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme gjatë procedurës së shqyrtimit, në lidhje me veprimin ose praktikën që bien në fushën e veprimit të ligjit;

d) të kryejë procedurën e hetimit administrativ, të marrë vendim për përfundimin e hetimit administrativ, apo mosfillimin e tij dhe ta dokumentojë atë;

dh) të marrë të gjitha masat për shqyrtimin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje të sinjalizuesit;

e) të raportojë mbi përfundimin e hetimit dhe problematikat e evidentuara gjatë procesit të shqyrtimit të hetimit administrativ pranë organeve mbikëqyrëse/drejtuese të subjektit privat;

ë) të ndjekë me përgjegjshmëri sinjalizimin, të informojë sinjalizuesin për ecurinë e tij dhe rezultatin përfundimtar, jo më vonë se 3 muaj nga data e konfirmimit të regjistrimit të sinjalizimit. Ky afat zbatohet edhe në rastet kur konfirmimi nuk është dërguar;

f) të sigurojë që mekanizmat e sinjalizimit të organizohen e të funksionojnë në mënyrë të sigurt, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit, të identitetit të sinjalizuesit dhe të çdo personi të tretë të përmendur në sinjalizim, si dhe duke parandaluar aksesin e paautorizuar ndaj informacionit të përfshirë në sinjalizim;

g) të sigurojë informacion të qartë e të kuptueshëm për procedurën e sinjalizimit të brendshëm, sinjalizimit të jashtëm pranë ILDKPKI-së apo sinjalizimit publik, përfshirë mënyrën e përdorimit të tyre;

gj) të informojë menjëherë sinjalizuesin jo vetëm për veprimet e ndërmarra ose të parashikuara si ndjekje të mëtejshme, por edhe për arsyetimin përkatës në çdo rast dhe pa qenë nevoja për kërkesë të posaçme nga sinjalizuesi;

h) të marrë masa për ndërgjegjësimin e punonjësve për trajtimin e sinjalizimit nëpërmjet mekanizmave të brendshëm të sinjalizimit, përpara përdorimit të mekanizmave të jashtëm, në rastet kur shkelja mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda institucionit dhe kur sinjalizuesi vlerëson se nuk ekziston rrezik hakmarrjeje;

i) të garantojë akses në të gjitha format e sinjalizimit, përfshirë ato verbale, me shkrim ose përmes mjeteve të tjera të njohura të komunikimit;

j) të paraqesë pranë ILDKPKI-së, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raportin vjetor të konsoliduar për sinjalizimet dhe kërkesat për mbrojtje të marra dhe trajtimin e tyre, sipas formatit të përcaktuar nga ky i fundit.

12. Subjektet private, në përputhje me aktet e tyre rregullatore, miratojnë rregullore të brendshme për procedurat e hetimit të sinjalizimit dhe masat për mbrojtjen e konfidencialitetit, si dhe përfshijnë funksionet e njësisë përgjegjëse në përshkrimet e punës së punonjësve të caktuar në këto njësi, në përputhje me ligjin dhe këtë udhëzim.

13. Subjektet private kanë detyrimin të sigurojnë kushtet dhe mjetet e nevojshme të punës e të komunikimit për punonjësit e njësisë përgjegjëse, në mënyrë që të ushtrojnë me efektivitet detyrat e tyre. Për palët e treta të jashtme, të caktuara si njësi përgjegjëse, përmbushja e këtij detyrimi rregullohet në marrëveshjen midis palëve.

14. Subjektet private njoftojnë menjëherë me

shkrim ILDKPKI-në, për ngritjen e njësisë përgjegjëse, si dhe punonjësin/t apo palën e tretë të jashtme të përzgjedhur për të kryer detyrat e përcaktuara sipas ligjit dhe këtij udhëzimi.

15. Subjektet private mund të caktojnë punonjës zëvendësues për të kryer detyrat sipas pikës 11 të këtij udhëzimi, në rastet kur sinjalizuesi parashtron rrethana për praninë e konfliktit të interesave të punonjësve të njësisë përgjegjëse.

16. Punonjësit e njësisë përgjegjëse, të caktuar sipas pikave 11 dhe 15 të këtij udhëzimi, japin pëlqimin e tyre me shkrim ku pranojnë detyrën e punonjësit të njësisë përgjegjëse.

17. Punonjësi i njësisë përgjegjëse duhet të përmbushë këto kritere:

a) të ketë mbaruar arsimin e lartë në shkencat juridike, shkencat sociale, shkencat ekonomike ose disiplina të tjera që lidhen me fushën e veprimtarisë së subjektit privat;

b) të ketë vjetërsi në profesion/punë jo më pak se 2 vjet;

c) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ç) të ketë njohuri mbi ligjin e sinjalizimit, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave;

d) të gëzojë integritet të lartë profesional;

dh) të mos ketë marrë masa disiplinore në tre vitet e fundit.

18. Në rastet e lëvizjes, largimit nga funksioni/detyra e punonjësve të njësisë përgjegjëse apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ndërmjet subjektit privat dhe punonjësit të njësisë përgjegjëse, njoftohet menjëherë ILDKPKI-ja. Subjekti privat merr masat e nevojshme për të zëvendësuar brenda 7 ditëve punonjësin e larguar të njësisë përgjegjëse, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

19. Punonjësi i njësisë përgjegjëse mund të largohet nga detyra e anëtarit të njësisë përgjegjëse, në rastet kur:

a) jep dorëheqjen me shkrim;

b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i paaftë për të vepruar;

ç) kryen shkelje të rëndë të legjislacionit që rregullon sinjalizimin;

d) përfundon marrëdhënia e punës sipas parashikimeve të Kodit të Punës;

dh) nuk paraqitet në punë pa shkaqe të justifikuara për më shumë se 3 muaj.

20. Në rast se subjektet private vendosin të caktojnë si njësi përgjegjëse një palë të tretë të jashtme, kjo e fundit duhet të përmbushë këto kritere:

a) të jetë person fizik ose juridik që ushtron aktivitet në fushën e auditimit, kontabilitetit apo avokatisë, dhe të jetë i licencuar për ushtrimin e këtij aktiviteti sipas legjislacionit në fuqi;

b) të ketë vjetërsi në ushtrimin e këtij aktiviteti jo më pak se 2 vjet;

c) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ç) të ketë njohuri mbi ligjin e sinjalizimit, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave;

d) të gëzojë integritet të lartë profesional.

21. Punonjësi apo pala e tretë e jashtme, e ngarkuar me trajtimin e sinjalizimit dhe kërkesës për mbrojtje, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, gëzon pavarësi në ushtrimin e kompetencave të tyre, veçanërisht në rastet kur sinjalizimi lidhet me veprimtarinë e punëdhënësit.

22. Punonjësi i autorizuar për regjistrimin dhe hetimin administrativ të sinjalizimit apo kërkesës për mbrojtje, gëzon të drejtën e mbrojtjes sipas këtij ligji nëse bëhet objekt i veprimeve hakmarrëse për shkak të ushtrimit të detyrës.

23. Nëse sinjalizimi apo kërkesa për mbrojtje është marrë nga një person që nuk është i autorizuar për të vepruar sipas ligjit, ky i fundit ka detyrimin ta përcjellë pa vonesë sinjalizimin apo kërkesën për mbrojtje pranë punonjësit të njësisë përgjegjëse ose pranë autoritetit kompetent, duke ruajtur identitetin e sinjalizuesit dhe të çdo informacioni, që mund ta zbulojë atë.

24. Punonjësit e njësisë përgjegjëse në subjektet private apo pala e tretë e jashtme, e angazhuar në përputhje me parashikimet e këtij udhëzimi, i nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive sipas ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, sipas kalendarit të trajnimeve të njoftuar paraprakisht nga ILDKPKI-ja.

25. ILDKPKI-ja krijon dhe mban të përditësuar Regjistrin Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në subjektet private, në zbatim të ligjit nr. 96/2025, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

26. Ngarkohen subjektet private sipas

përcaktimit të bërë në ligjin nr. 96, datë 18.12.2025, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", për zbatimin e këtij udhëzimi.

27. Mosrespektimi i këtij udhëzimi përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 27, të ligjit nr. 96/2025, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

28. Subjektet private caktojnë punonjësit e njësisë përgjegjëse apo palën e tretë të jashtme të ngarkuar për këtë qëllim, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi dhe njoftojnë me shkrim ILDKPKI-në për krijimin e njësisë përgjegjëse, së bashku me kontaktet e personave përgjegjës.

29. Subjektet private miratojnë, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96, datë 18.12.2025, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", aktet e parashikuara në pikën 12 të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Evgjeni Bashari

KËRKESË
Nr. 276/8, datë 30.4.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, 'Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në njësitë administrative nr. 7 + 9 + 10 – rrugët 'Milo Duçi' dhe 'Prenkë Jakova', Bashkia Tiranë"', me subjekt kërkues, Bashkia Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

- Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të përllogaritur për pasuritë e llojit "truall", bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

- Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si dhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Tiranë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

- Vlera totale paraprake e shpronësimit është në shumën 2,780,208 lekë (dy milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e tetë) lekë, përllogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 7+9+10 – RRUGËT 'MILO DUÇI' DHE 'PRENKË JAKOVA"'

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore									Vlerësimet për shpronësim						Vlera totale (lekë)	Shënime (kufizime hipotekore barre mbi pasurinë etj.)
													Truall			Ndërtesë				
	Emër	Atësi	Mbiemër	Qyteti	ZK	Nr .i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Vol.	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Shtet			Tiranë	8210	2/404	Trotuare	1313.93	0	0	24	70	3.3	0.00	0.00	0		0	0.00	
2	Shtet			Tiranë	8210	2/262	Rrugë	3813.09	0	0	7	192	138.3	0.00	0.00			0	0.00	
3	Shtet			Tiranë	8210	2/191	Rrugë	1737.51	0	0	7	206	84.9	0.00	0.00			0	0.00	E- I shtohet sipërfaqja prej 33.05 m² e cila i shtohet pasurisë për efekt të lejes së legalizimit nr. 17858, datë 24.10.2012 (pas. nr. 2/174) i zbritet sip. 13.35 m² e cila i shtohet pas nr. 2/194 për efekt të l. leg (r. 10741)
4	Shtet			Tiranë	8210	3/210	Trotuare	381.09	0	0	26	226	17.7	0.00	0.00			0	0.00	E-Sipërfaqja ndryshuar me urdhrin nr. 4584, datë 19.12.2013.
5	Shtet			Tiranë	8210	2/437	Rrugë	786.98	0	0	25	79	533.6	0.00	0.00			0	0.00	
6	Dilaver	Shyqeri	Çeka	Tiranë	8210	2/564	Truall	237.5	237.5	110.5	41	235	6.2	38,614.00	239,406.80			0	239,406.80	E- Leje legalizimi nr. 1232084, datë 24.2.2020, godinë banimi 1 kat. sip. e katit përdhe 110.5 m². sip. trualli 237.5 m²
7	Arjan Rolanda	- Agim	Sinanaj Çeka	Tiranë	8210	2/733	Truall	340	340	82	52	46	1.8	38,614.00	69,505.20			0	69,505.20	E- Godinë banimi 2-katëshe
8	Shtet			Tiranë	8210	2/231	Rrugë	779.94	0	0	7	197	575.3	0.00	0.00			0	0.00	
9	Shtet			Tiranë	8210	2/219	Rrugë	820.65	0	0	7	196	538	0.00	0.00			0	0.00	
10	Shtet			Tiranë	8210	2/39	Rrugë	2986.26	0	0	7	190	436.3	0.00	0.00			0	0.00	C- Akte të tjera noteriale. D - Ka 1 ndërtim pa leje.
11	Shtet			Tiranë	8210	2/124	Rrugë	210.43	0	0	23	115	3.5	0.00	0.00			0	0.00	
12	Shtet			Tiranë	8210	3/174	Rrugë	145.69	0	0	7	201	131.2	0.00	0.00			0	0.00	Me shkresën nr. prot. 4233/3, datë 24.6.2025 të ASHK Tirana Veri është konfirmuar shtet.
13	Artur Agim Ardiana Azem Beqir Ervis Fatbardh Fatime Fitnete Hamdi Hava Hazbije Hyqmet Ilir Isuf Kadri Lirije Mirela Muhamed Muharrem Naxhije Nysrete	Et'hem Et'hem - - - - - - - - - - - - - - - - - - Halit -	Kurti Gjuzi Gjuzi Sedja Sedja Sinella Allajbeu Bishqemi Sedja Allajbeu Kullolli Sedja Shyti Gjuzi Gjuzi Allajbeu Allajbeu Isufi Allajbeu Sedja Sinella Bishqemi Shyti Muka Sedja Hashini Sinella Sedja Hoxha Kanapari Sedja Harizi Allajbeu Allajbeu Kurti Kurti Mara Sedja	Tiranë	8210	3/123	Truall	1009.05	1009.05	0	8	86	56.3	38,614.00	2,173,968.20			0	2,173,968.20	C- Mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa nr. 3/46-nd., vol. 40, faqe 237 l. leg. d- ka 5 ndërtime pa leje pala e porositur Nimet Balili do të përfitoj 3% të sipërfaqes sipas kontratës nga secila palë porositëse Edlira Malile, Hidajete Hoxha Mukades Karkini k. porosie 1089/580, datë 19.5.2018.

	Petrit Rabihane Ramazan Resmije Rovena Ruzhdi Sabije Servete Sulejman Vjollca Xhavit Xhevdet Asim Astrit Bujar Dylaver Edlira Edvin Emona Engjellushe Ermon Hidajete Lirie Mukades Neim Sabiha Sezar Teuta Xhamide Agim Ali Ballkiz Hasan Mehmet Mimoza Nadire Rudina	- - - - - - - - Ismail - - - - - - - Bujar Bujar - - - Haki - - - - - Hajdar Abaz - - - Abdulla - - -	Malile (Balili) Mara Mara Kurti Kurti Sinella Gumeni Sinella (Karkini) Kurti Kurti Malile Vrahoriti (Kurti) Kurti Sami Dollia Struga Sami Struga Kurti Konci Mamo (Struga)																	
14	Shtet			Tiranë	8210	2/47	Rrugë	394.49	0	0	7	191	332	0.00	0.00			0	0.00	
15	Shtet			Tiranë	8210	2/668	Truall	157	157	0	40	224	1.3	0.00	0.00			0	0.00	
16	Avni	Zenel	Selfollari	Tiranë	8210	3/386	Truall	425	425	87.7	43	171	7.7	38,614.00	297,327.80			0	297,327.80	D- Kontratë Sipërmarrjeje/ Aktmarrëveshje Ndërmjet Zhvilluesit Të Pronës Dhe Pronarëve Të Truallit. E - L. Leg. Nr. 1233277, Datë 23.9.2020, Objekt Banimi 2-Katëshe Kati Përdhe Sip. Banimi 87.7m² Sip. Verandë + Shkallë 14.3 M² Kati I Parë : Sip. Banimi 100 M²
	VLERA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT												**2867.4**		**2,780,208.00**				**2,780,208.00**	**Lekë**

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me vendimin nr. 62-2026-1590 (163), datë 12.3.2026, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Shpëtim Dauti, me atësi Jaup dhe amësi Feruze, i datëlindjes 24.8.1972, duke caktuar si datë të vdekjes datën 1.10.1991.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2026/05/06 16:24:25 +02'00'
f247b1bc51314669aa596439882efa65

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)